



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 696 Prot.

Tiranë, më 03/04/2018

VENDIM QARKULLUES

Nr. 26, datë 03.04.2018

PËR

**PËR NJË SAKTËSIM NË RREGULLOREN E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA TË
CIKLIT TË TRETË, NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË**

Bazuar në nenin 38, pika 1, germa d) e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 15 e vijues të Statutit të UMT-së dhe sipas propozimit të Rektoratit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Senati Akademik, me qëllim harmonizimin e përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Rregullores së Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Në Rregulloren e Specializimeve Afatgjata, të Ciklit të Tretë, në Fushën e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 88, datë 16.11.2016 “Për miratimin e Rregullores së Specializimeve.....”, dhe ndryshuar me vendimin nr. 67, datë 21.12.2017, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

Neni 39 bëhet:

Si notë mesatare do të konsiderohet nota mesatare e ponderuara, të të gjitha viteve të studimeve universitare të kryera, duke përfshirë dhe diplomimin.

Për kandidatët që kanë kryer studimet në IAL private brenda vendit, nota mesatare shumëzohet me një koeficient 0,8. Për kandidatët që kanë kryer studimet në IAL publike ose private brenda vendit, të cilat lëshojnë diploma të përbashkëta me universitete perëndimore, të përcaktuara në shtojcën nr. 1, nota mesatare shumëzohet me një koeficient 1. Për kandidatët që kanë kryer studimet në IAL publike brenda vendit nota mesatare shumëzohet me një koeficient 1, për kandidatët që kanë kryer studimet jashtë vendit në një nga vendet e parashikuara në shtojcën nr. 1, nota mesatare shumëzohet me 1,1.

Konvertimi i pikëve nga nota mesatare e përlogaritur si më sipër duke e shumëzuar dhe me koeficientin përkatës, bëhet sipas modalitetit të përshkruar më poshtë: Nota mesatare e

përlllogaritur 10 = 300 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 9 = 240 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 8 = 180 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 7 = 120 pikë të konvertuara, nota e përlllogaritur 6 = 60 pikë të konvertuara , nota e përlllogaritur 5 = 0 pikë të konvertuara. Çdo 0.10 e notës mesatare të përlllogaritur është baras me 6 pikë të konvertuara (p.sh. nota mesatare 7,10 = 126 pikë të konvertuara, 8,20 = 192 pikë të konvertuara, 9.34 =260.4 pikë të konvertuara, etj.).

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, u njoftohet fakulteteve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe publikohet në web site-n e institucionit.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Arben Gjata

